



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**  
**OSNOVNI SUD DJAKOVICA – BASIC COURT OF GJAKOVË**

---

**AD/GJTHGJA. nr. 23-2022**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË** – Kryetari i Gjykatës Nikollë Komani, në çështjen e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit Nj. M., duke vepruar sipas ankesës së parashtruar nga S. M. nga Malisheva, pas shikimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të ankesës, me datë 30 dhjetor 2022 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Refuzohet ankesa disiplinore e parashtruar nga S. M. nga Malisheva, ndaj gjyqtarit Nj. M., si e pabazuar.

**A r s y e t i m**

Parashtruesi i ankesës, S. M. nga Malisheva, me datë 12 dhjetor 2022, ka dorëzuar ankesën ndaj gjyqtarit Nj. M., të cilës ankesë i'a ka bashkangjitu aktgjykimin P.nr.274/2015 së bashku me prova tjera.

Pas pranimit të kësaj ankesë dhe analizimit të përmbajtjes së saj, e njëjta është regjistruar në librin e ankesave disiplinore me nr. AD/GJTHGJA.nr. 23/2022, datë 12 dhjetor 2022 dhe janë ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore që janë në kompetencë të kryetarit të Gjykatës, sipas Ligjit për “Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë”.

Me shkresën AD/GJTHGJA. nr. 23-2022 të datës 12 dhjetor 2022, është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se janë ndërmarrë veprimet lidhur me ankesën e parashtruar nga ana e ankuesit.

Ankuesi S. M., ka parashtruar ankesë ndaj gjyqtarit Nj. M., me arsyetimin se gjatë procedurës penale të zhvilluar ndaj tij nuk është trajtuar në mënyrë të duhur ligjore,”*për arsye që gjatë procedurës penale ndaj meje si i akuzuar janë shkelur të drejtat e mija, për më tepër në këtë çështje penale aktakuza në gjykatë është parashkruar me datë 19.02.2015, ndërsa shqyrtimi fillestar është mbajtur me datë 03.02.2019. Gjykatësit i është dashur një kohë prej 4 vjet e 2 muaj e 14 ditë për të filluar ta trajtojë çështjen penale ndaj meje, në këtë mënyrë është shkelur parimi për gjykim të drejtë, të paanshëm dhe në afat të arsyeshëm të përcaktimi në nenin 5 të Kodit Penale të Kosovës. Se nuk jam trajtuar në mënyrë të drejtë nga ana e gjykatës vërtetohet edhe me faktin se ndërmjetë shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 27.04.2022 dhe shqyrtimit kryesor të datës 16.09.2022 ka kaluar një periudhë kohore prej 4 muaj e 20 ditë, ku gjykatësi ka shkelur nenin 311 par. 3 të KPP-së, ku thotë se kur shqyrtimi gjyqësor ka zgjatur më shumë tre (3) muaj ose kur shqyrtimi gjyqësor mbahet para një kryetari tjetër të trupit gjykuese, shqyrtimi gjyqësor duhet të filloj rishtas dhe përseri të shqyrtohen të gjitha provat. Përkundër kësaj gjykata në aktgjykimin e saj e ka arsyetuar se përfaqësuesi i palës së dëmtuar av. L. S. e ka lajmëruar gjykatën se bashkëshortja e tij është me Covid dhe se të gjitha palët janë njoftuar nga gjykata dhe gjykatat ka mbajtur procesverbal.*

Unë konsideroj se kjo nuk mund të arsyetohet, sepse avokatin ka mund ta zëvendësoj ndonjë koleg i tij siç e ka zëvendësuar në seancat e mëparshme. Në procesverbalin të dt. 27.04.2022 është caktuar seanca e radhës me datë 01.06.2022 dhe e njëjta seancë nuk është mbajtur dhe për këtë mbrojtësi im av. N. P. është njoftuar vetëm përmes telefonit, se nuk do të mbahet seanca gjyqësore e caktuar nga vet gjyqtari, me arsyetimin se prokurori i shtetit K. M. nuk mund të marr pjesë, për arsye se i njëjti ka qenë në pushim mjeksorë dhe se ka shprehur dëshirën që vetë të jep fjalën përfundimtare dhe për këtë gjykata nuk më ka paisur me ndonjë procesverbal vetëm është njoftuar me një njoftim përmes telefonit, të cilin ja ka bërë av. N. P. . Për të gjitha seancat e shtyra unë jam njoftuar vetëm përmes avokatit tim. Po ashtu ndaj meje gjatë shqyrtimit gjyqësor me datë 16.09.2022, me që unë kam kërkuar nga gjyqtari i çështjes se përfaqësuesi i palës së dëmtuar av. L. S. a ka prezentuar ndonjë dokument mjeksorë, për të cilën arsye gjykata e ka shtyrë shqyrtimin gjyqësor paraparak, për të cilin nuk është mbajtur ndonjë procesverbal, gjyqtari i çështjes penale më ka fyer se jam i pandërgjegjshëm dhe për të njëjtin nuk është mbajtur shënim në procesverbal dhe për këtë janë dëshmitarët pjesmarrës në procedurë penale av. N. P., si dhe medijat prezent për monitorimin e kësaj çështje penale, i cili fakt më jep arsye të dyshoj lidhur me marrjen e vendimit të ligjshëm në këtë çështje penale ndaj meje. Me dt. 25.03.2022, gjatë leximit të provave gjyqtari nuk i lexoj 3 prova, të cilat ishin pjesë e shkresave të lëndës, ekstrakti Azazbuqni Refister, i cili mbante emrin F. R. H. i nacionalitetit rom, gazeta Koha Ditore e datës 03.11.2014, e cila shkruante se i dëmtuari kishte kërkuar pronë rreth Kuvendit Komunal, fotografit e lokaleve të datës 23.06.1993, ku kjo fotografi tregonte ku unë kisha filluar ndërtimin e lokaleve pra se të hiqej ambulanca. Av. N. P., i propozoi këto prova, mirëpo ende pa reaguuar prokurori, gjyqtari reagoi dhe tha këto prova nuk janë as tek unë e as tek prokurori, këto tri prova të cilat ishin prova vendimtare janë zhdukur nga provat e lëndës si nga gjyqtari, ashtu edhe nga prokuroria dhe unë kam reaguuar disa herë për këto prova. Këto prova ish avokati im R. H. i kur ka pranuar komplet lëndën nga Prokuroria e Gjakovës, kur kanë ekzistuar këto tri prova. Në aktgjykimin e datës 20.10.2022, në lëndën P.nr. 274/2015 gjyqtari më thotë se i akuzuari është i lindur në vitin 1954 dhe vëllai i tij Rrustemi është i lindur në vitin 1934 dhe më thotë se dallimi në moshë është 20 vite, në të vërtetë gjyqtari bie ndesh me vetveten se shënimet e mia i ka në faqen e parë të aktgjykimit, unë jam i lindur në vitin 1948 dhe në vitin 1954 kam qenë 6 vjeçar, një fëmijë 6 vjeçar mund të përkund një djep këtu vëlla im tim të ndjer Rrustem, i cili ka qenë me të meta fizik dhe gjatë gjithë jetës është përkundër në djep, sepse gjatësia e tij ishte 1 metër, apo 1 meëer e 10 cm, shiqoni aktgjykimin në faqenë 9 në rreshtin 37. Gjithashtu gjyqtari bie ndesh me vetvetem dhe na bënë të paditur dëshmorin e kombit B. B. me datë 02.06.1999 herokisht ka rënë dëshmor në fshatin Lladrovç, emrin e Brahimit nuk e ka lakuar as në gjykim as në aktgjykim apo procesverbal, kështu që unë si i akuzuari dhe familja e gjërë e B. ndihem të fyer nga ky gjyqtar, i cili na merr dëshmorin nëpër shkresat e lëndës. Të akuzuarit i thotë të pandërgjegjesë, çka e shtyri këtë gjyqtar të më ofendon në këtë mënyrë, a thua gjyqtarit këto fyerje a ja jep ektika i cili me fyen mua si i akuzari, fyen dëshmorin, fyen familjen.”

Gjyqtari Nj. M., në deklaratën e tij të dhënë me shkrim ka theksuar se: “pas përfundimit të Akademisë i ka marrë rreth 600 lëndë, e ndër to edhe lënda e S. M., e cila evidentohet me numër P.nr. 274/15, të cilat më janë caktuar në mesin e muajit dhjetor të vitit 2018, e të njëjtën e kam caktuar për herë të parë në muajin shkurt të vitit 2019, e ku në fillim nuk ka pasur avokat mbrojtës, pastaj e ka angazhuar avokatin N. P. nga shqyrtimi i dytë e deri në fjalën përfundimtare. Asnjëherë gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka kërkuar përjashtimin tim, as i pandehuri Sadri, e as i mbrojturi i tij e as një palë tjetër në procedurë, të gjitha procesverbalet i kanë nënshkruara nga palët. Fjala përfundimtare është dhënë me datë 16.09.2022, ndërsa shpallja e aktgjykimit është bërë me datë 21.09.2022, ku kanë qenë prezent përveç të akuzuarit S. edhe dy gazetarë-Betim për Drejtësi në web faqe Betimi për Drejtësi atë ditë po

*të ishte diçka të dyshimit, ishte botuar nga Betimi për Drejtësi. Gjykata ka përpiluar aktgjykimin e numër P.nr. 274/2015 me datë 20.10.2022, u janë ekspeduar palëve dhe të njëjtit kanë ushtruar ankesë dhe lënda është në apel. Sa i përket pretendimeve të pandehurit se këto tri prova ishin prova vendimtare dhe janë zhdukur nga shkresat e lëndës nga gjyqtari, unë jam i gatshëm të ballafaqohem me procedurë gjyqësore, pasi të gjitha provat që kanë qenë në lëndë, të gjitha janë në lëndë dhe të njëjtat janë lexuar në shqyrtim gjyqësor dhe janë nënshkruar nga të gjitha palët. Ka shtuar se këtë deklaratë e them nën betim dhe jam i gatshëm të përgjigjem si para përgjegjësisë penale po ashtu edhe para përgjegjësisë etike për pretendimet e të akuzuarit, të njëjtat janë shpifje dhe trillime.”*

Kryetari i Gjykatës, lidhur me këtë çështje-ankesë ka siguruar shkresat e lëndës P.nr.274/15, nga e cila lëndë vërtetohet se në këtë çështje penale ankuesi e ka cilësinë e të akuzuarit dhe se aktakuza është dorëzuar në Gjykatën Themelore në Gjakovë me datë 19 shkurt 2015 dhe me aktvendimin e kryetarit të trupit gjykues PKR.nr.35/2015 të datës 14 maj 2015, Gjykata Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, është shpallur jo-kompetent dhe lënda është dërguar në Gjykatën Themelore në Gjakovë - Dega në Malishevë, si gjykatë me kompetencë territoriale dhe lëndore. Gjyqtari Nj. M., me këtë lëndë është ngarkuar me datë 27 nëntor 2018, pasi më parë ka qenë te një gjyqtar tjetër dhe bazuar në shkresat e lëndës shqyrtimi fillestar është caktuar për datën 03 maj 2019, shqyrtimi i dytë është mbajtur me datë 05 qershor 2019, me ç’rast është marrë aktvendim P.nr. 274/15 i datës 05 qershor 2019 me të cilën është refuzuar si e pa bazuar kërkesa për hedhjen e aktakuzës e parashtruar nga i pandehuri S. M., për shkak të veprës penale legalizim i përmbytjes së rreme nga neni 403 par. 1 të KPRK-së. Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN.nr. 692/19 të datës 26 korrik 2019, e cila është pranuar në Gjykatën Themelore në Gjakovë - Dega Malishevë, me datë 14 tetor 2019 është refuzuar si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të pandehurit S. M., avokatit Naser Peci, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega në Malishevë P.nr.274/15 i datës 05 qershor 2019. Bazuar në shkresat e lëndës ky vendimi i është ekspeduar palëve dhe shqyrtimi gjyqësor është caktuar për datën 17 korrik 2020, ku bazuar në shkresat e lëndës, janë mbajtur në vazhdimësi seanca gjyqësore deri në përfundimin e shqyrtimit, me datë 21 shtator 2022, ku është përpiluar aktgjykimi P.nr. 274/15 kundër të cilit aktgjykim të gjitha palët kanë ushtruar ankesë dhe lënda gjendet në Gjykatën e Apelit, sipas ankesës së palëve.

Kryetari i Gjykatës, pas analizimit dhe vlerësimit të ankesës së ankuesit, shkresave të lëndës dhe deklaratës së gjyqtarit, gjeti se ankesa është e pabazuar.

Kryetari i Gjykatës, ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e ankuesit se nga ana e gjyqtarit gjatë zhvillimit të procedurës penale janë shkelur të drejtat e tija për faktin se aktakuza në gjykatë është paraqitur me datë 19 shkurt 2015, ndërsa shqyrtimi fillestar është mbajtur me datë 03 shkurt 2019, pra është dashur të kaloj kohë prej katër (4) vjet e dy (2) muaj e katërbëdhjetë (14) ditë, për të filluar të trajtohet kjo çështje penale, në këtë mënyrë është shkelur parimi për gjykim të drejtë, të paanshëm dhe në afat të arsyeshëm të paraparë me nenin 5 të KPRK-së. Bazuar në shkresat e lëndës është vërtetuar se është e vërtetë se aktakuza është dorëzuar në Gjykatën Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda me datë 19 shkurt 2015, e ku kryetari i trupit gjykues me aktvendimin PKR.nr. 35/2015 të datës 14 maj 2015, është shpallur jo kompetent dhe lënda është dërguar në Gjykatën Themelore në Gjakovë – Dega në Malishevë, si gjykatë me kompetencë territoriale dhe lëndore. Pas pranimit të kësaj

lëndë në Degën e Malishevës me këtë lëndë ka qenë i ngarkuar gjyqtari Lutfi Shala, ndërsa bazuar në shkresat e lëndës gjyqtari Nj. M., me këtë lëndë është ngarkuar me datë 27 nëntor 2018, ndërsa shqyrtimi fillestar është caktuar dhe mbajtur me datën 03 maj 2019. Andaj, bazuar në këto konstatime gjyqtari Nj. M., pas pranimit dhe ngarkimit me këtë lëndë brenda pesë (5) muajve e ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar, shqyrtimin e dytë e ka mbajtur me datë 06 qershor 2019, pra në veprimet e gjyqtarit Nj. M., nuk janë konstatuar vonesa në trajtimin e lëndës dhe se i njëjti nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për përudhen kohore për të cilën nuk ka qenë i ngarkuar me këtë lëndë, andaj mbi këtë baza dhe këto konstatime është vërtetuar se pretendimet e ankuesit janë të pabazuara.

Pretendimet e ankuesit se nuk është trajtuar në mënyrë të drejtë për faktin se ndërmjet shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 27 prill 2022 dhe shqyrtimit të datës 16 shtator 2022, ka kaluar një periudhë kohore prej katër (4) muaj e njëzet (20) ditë dhe bazuar në nenin 311 par . 3 të KPP-së, parashihet se kur shqyrtimi gjyqësor ka zgjatur më shumë se tre (3) muaj ose kur shqyrtimi mbahet para një kryetari tjetër të trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të filloj rishtas dhe përsëri duhet të shqyrtohen të gjitha provat bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht procesverbalet e shqyrtimeve gjyqësore, ky pretendim i ankuesit është i pabazuar. Se ky pretendim i ankuesit është i pabazuar është argumentuar nga procesverbalet e shqyrtimeve gjyqësore të mbajtura lidhur me këtë çështje penale ku me datë 27 prill 2022, është mbajtur shqyrtimi gjyqësor dhe seanca e radhës është caktuar për datën 01 qershor 2022. Nga procesverbali i datës 01 qershor 2022 është e konstatuar se shqyrtimi gjyqësor nuk do të mbahet për faktin se prokurori, përmes e-mail-it zyrtar i cili është bashkëngjitur shkresave të lëndës, ka njoftuar gjykatës se për arsye të pushim mjekësor nuk mund të marrë pjesë në seancë dhe në këtë procesverbal është e konstatuar se gjykata, në të njëjtin e-mail ju ka dërguar avokatëve në procedurë dhe në shkresat e lëndës gjendet i bashkëngjitur edhe e-mail-i i dërguar nga prokurori K. M. me datë 30 maj 2022 në ora 12:02 minuta. Po ashtu, nga procesverbali i datës 22 qershor 2022 është e konstatuar se nuk prezanton përfaqësuesi i të dëmtuarës, avokati L. S., i cili ka njoftuar Gjykatën se nuk mund të marr pjesë në këtë seancë për shkak të gjendjes shëndetësore të babait të tij dhe ka kërkuar nga Gjykata që seanca të shtyhet për një ditë tjetër pasi që nuk ka pasur mundësi që të jap autorizim zëvendësues ndonjë avokati tjetër për faktin se gjendet në Tiranë dhe po të njëjtën ditë palët përmes telefonit janë njoftuar se shqyrtimi gjyqësor nuk do të mbahet ndërsa seanca e radhës është caktuar për datën 27 korrik 2022. Nga procesverbali i datës 27 korrik 2022 është e konstatuar se shqyrtimi gjyqësor nuk është mbajtur për faktin se përfaqësuesi i palës së dëmtuar përmes e-mail-it zyrtar të datës 25 korrik 2022, i cili gjendet në shkresat e lëndës, ka njoftuar gjykatën se për arsye se bashkëshortja e tij është e diagnostikuar me covid 19 nuk mund të marr pjesë në shqyrtim gjyqësor, ndërkaq seanca e radhës është caktuar dhe mbajtur me datën 16 shtator 2022. Andaj, bazuar në faktin se shqyrtimet gjyqësore kanë qenë të caktuara por që nuk janë mbajtur sipas kërkesës së palëve, nuk plotësohen kushtet ligjore të parapara me nenin 311 par. 3 të KPP-së, gjegjësisht nuk konsiderohet se shtyrja ka zgjatur më shumë se tre muaj ashtu siç pretendon ankuesi, ashtu që në këtë drejtim nuk është konstatuar se janë shkelur të drejtat ligjore të ankuesit.

Pretendimet e ankuesit se në shqyrtimin gjyqësor të datës 16 shtator 2022, kur është dhënë fjala përfundimtare, gjyqtari e ka fyer ankuesin me falët se je i pandërgjegjshëm dhe sipas pretendimeve të ankuesit nuk është mbajtur shënim në procesverbal por janë dëshmitaret si mbrojtësi i tij, avokati N.

P., si dhe mediat që e kanë monitoruar seancën, janë analizuar dhe vlerësuar nga kryetari i Gjykatës dhe fillimisht bazuar në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor askund nuk është konstatuar ky fakt, palët pasi e kanë dhënë fjalën përfundimtare e kanë nënshkruar procesverbalin pa vërejtje, pastaj as në ankesat e ushtruara ndaj aktgjykimit nga ana e mbrojtjes askund nuk përmendet ky fakt, e po ashtu edhe monitoruesit të cilët kanë qenë të pranishëm gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor në raportet e tyre nuk e kanë konstatuar këtë pretendim të ankuesit, pasi nga faqja zyrtare e Betimit për Drejtësi është nxjerr raportimi i bërë me datë 16 shtator 2022 nga dy gazetaret e pranishme gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe askund nuk është përmendur ky pretendim i ankuesit, gjegjësisht te kryetari i Gjykatës nuk është paraqitur ndonjë kërkesë në këtë drejtim, andaj ky pretendim i ankuesit është i pabazuar pasi që nuk është i argumentuar me asnjë provë apo fakt të vetëm.

Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar dhe analizuar edhe pretendimet tjera të ankuesit lidhur me tri provat për të cilat ankuesi pretendon që i janë zhdukur nga shkresat e lëndës dhe bazuar në shkresat e lëndës të cilat janë siguruar komplet dhe regjistrin e shkresave të regjistruara, askund nuk janë të konstatuara këto prova e po ashtu edhe gjyqtari në deklaratën e tij është shprehur se të gjitha provat që kanë qenë në lëndë janë administruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore, askund nuk është dëshmuar se këto prova janë dorëzuar në gjykatë ashtu siç pretendon ankuesi. Po ashtu janë vlerësuar edhe analizuar edhe pretendimet tjera të ankuesit të cilat kanë të bëjnë me rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor dhe është vlerësuar se këto pretendime të ankuesit janë në kompetencë dhe do të trajtohen nga Gjykata e Apelit e Kosovës, sipas ankesës së parashtruar nga të gjitha palët, si dhe nga shkresa e bërë nga vet ankuesi me titull Njoftim, drejtuar Gjykatës së Apelit ku i ka përmendur jo vetëm provat por edhe të gjitha pretendimet tjera. Andaj, mbi këto baza është konstatuar se në veprimet e gjyqtarit nuk janë konstatuar shkelje të cilat do të konsideroheshin shkelje disiplinore, për këto arsye kryetari i Gjykatës gjeti se pretendimet ankimore janë të pabazuara, pasi nga të lartcekurat nuk rezulton se veprimet e ndërmarra nga gjyqtari Nj. M., përbëjnë bazë për iniciimin e procedurës disiplinore në Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Nga arsyet e theksuara më lartë, si dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 9 par. 6 të Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenit 7 par. 3 pika 3.2 të Rregullores 05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**AD/GJTHGJA. nr. 23-2022, datë 30.12.2022**

**Kryetari i gjykatës**  
**Nikollë Komani**

**Udhëzim juridik:** Kundër këtij aktvendimi bazuar në Ligjin nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve nuk parashihet e drejta e ankesës.

**Vendimi t'i dorëzohet:**

1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
2. Parashtruesit të ankesës,
3. Gjyqtarit/es,